

20240741579

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J I

#### **I GARANCISË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR DETYRIMET SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË TË HUAS, E CILA DO TË NËNSHKRUHET NDËRMJET BANKËS ZHVILLIMORE TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE SHA “BANKA ZHVILLIMORE E MAQEDONISË SË VERIUT” – SHKUP, PËR HUANË PROGRAMUESE TË SHA “BANKA ZHVILLIMORE E MAQEDONISË SË VERIUT” – SHKUP, PËR KRIJIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME NË MAQEDONINË E VERIUT**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton përmbushjen e detyrimeve nga Marrëveshja kornizë e huas që do të nënshkruhet ndërmjet Bankës Zhvillimore të Këshillit të Europës dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, për Huanë programuese për SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup në vlerë prej 50.000.000 euro për krijimin e vendeve të punës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut, në qoftë se SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup nuk i përmbush dhe i servison detyrimet brenda afateve dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen kornizë.

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen kornizë të huas që do të nënshkruhet ndërmjet Bankës Zhvillimore të Këshillit të Europës dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, për Huanë programuese për SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, për krijimin e vendeve të reja të punës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut.

#### Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që rezultojnë nga Marrëveshja kornizë për huanë nga neni 2 i këtij ligji do t'i servisojë SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup.

#### Neni 4

Huaja sipas nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet më së paku në dy transhe.

Për çdo tërheqje të vlerës së huas në transhe, Banka Zhvillimore e Këshillit të Europës do të lëshojë Njoftim të tërheqjes, në të cilin do të përcaktohen kushtet financiare përfundimtare të transhesë, duke përfshirë: vlerën e transhesë, datën e pagesës, normën e interesit, afatin e shlyerjes dhe kushtet e tjera për tërheqjen e mjeteve.

Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet për çdo transhe veçmas në njoftimin për tërheqjen e transhesë.

Afati i shlyerjes për çdo transhe të huas, përveç transhesë së mjeteve qarkulluese, nuk do t'i kalojë tetë vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej një viti.

Afati i shlyerjes së çdo transheje të mjeteve qarkulluese nuk do t'i kalojë tri vite, pa përfshirë periudhën grejs.

#### Neni 5

Norma e interesit do të përcaktohet për çdo transhe të huas veçmas në njoftimin për tërheqjen e transhesë.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja kornizë e huas dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.